

RAPORT ZVOGËLIM KAPITALI

Përgatitur nga: Eftali Qirjaqi, Auditues Ligjor

Adresa : Lagjja "Qemal Stafa" , Rr "Studenti" , Shkodër

Drejtuar : Z. Behar Bërdica, Zj. Frida Selfo , Z. Ardit Selfo, Ortakë të Shoqërisë Tregtare "Bërdica Cement" Shpk me nipt. L01724501I, dhe Adresë : Xhafzotaj-Durrës, në ambjentet e magazinës të shoqërisë Pelikan , Durrës

Unë Eftali Qirjaqi , Auditues ligjore e liçensuar me numër liçense 11 datë 11.01.2000, pranova misionin e ngarkuar nga Ortakët e "Berdica Cement" Shpk, Durrës , Z. Behar Bërdica, Zj. Frida Selfo dhe Z. Ardit Selfo , për të hartuar raportin e zvogëlimit të kapitalit për këtë shoqëri, si rezultat i tërheqjes (largimit) nga shoqëria të ortakëve Zj. Frida Selfo dhe Z. Ardit Selfo, kapital i krijuar në krijimin e shoqërisë nga kontributi minimal në të holla dhe zmadhimin në vazhdimësi me fitimet e brendshme në shoqëri të krijuara ndër vite.

Vendimi Juaj i marrë me datën 26/04/2021, për zvogëlimin e kapitalit themeltar, kërkon që unë si Auditues Ligjore , të bëj verifikimin e dokumentacionit përkatës që lidhet me pasqyrimin e këtij kapitali (të shtuar nga fitimet dhe rezervat) në bilancet e shoqërisë, të dhënat e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, verifikimin e dokumentacionit kontabël, verifikimin e fitimeve që kanë shtuar më parë kapitalin, paraqitja e rregjistrimeve në kontabilitet. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e dokumentacionit, siç janë pasqyrat financiare me pjesët përbërëse, të hartuara në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, parimet dhe rregullat e të cilave janë përcaktuar në Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatova se:

Shoqëria "Berdica Cement ", është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, regjistruar në OKR me çështje CN-397768-05-10 me datë 24/05/2010. Kapitali para zvogëlimit paraqitet në ekstrakt dhe pasqyra financiare në vlerën 261,510,000 lekë, i ardhur nga 100 mijë lekë kontribut fillestar në të holla në momentin e rregjistrimit të shoqërisë dhe 261.410.000 lekë shtuar me fitimet e brendshme ndër vite nga momenti i krijimit deri më datën 31.12.2020. Pjesët e kapitalit para zvogëlimit zotërohen nga ortakët, Behar Bërdica me 50 % të kuotave , Frida Selfo me 25 % të kuotave dhe Ardit Selfo me 25 % të kuotave. Numri i pjesëve është 100 vlera e një pjese para zvogëlimit është 2,615,100 lekë. Shoqëria "Berdica Cement" është pajisur me numër unik identifikimi të subjektit (NIPT) L01724501I, Adresa: Xhafzotaj- Durrës , në ambjentet e magazinës të Shoqërisë Pelikan , Durrës . Data e themelimit të Shoqërisë 21/05/2010 .

- Vendimi i datës 26/04/2021, i ortakëve të shoqërisë, për largimin e ortakëve Zj, Frida Selfo dhe z, Ardit Selfo për zvogëlimin e kapitalit themeltar është marrë në zbatim të nenit 44 pika c) të ligjit të Shoqërive Tregtare 9901 datë 14/04/2008, neni 81 pika ë) dhe pasi Shoqëria ka aktive dhe mundësi për sigurimin dhe mbulimin e pakësimit në formen e aktiveve financiare dhe likuiditeteve në të holla.
- Rregjistrimet në kontabilitet, të vendimit të ortakëve për zvogëlimin e kapitalit themeltar me 50 % të kuotave nga zj. Frida Selfo me 25 % te kuotave dhe z, Ardit Selfo me po 25 % te kuotave të cilët largohen nga shoqëria duke tërhequr kapitalin themeltar të nënshkruar dhe rregjistruar në shumën e plotë të kuotave pjesëmarrëse 50 % ose 130,755,000 lekë, për zvogëlimin e kapitalit themeltar i nga të cilat 65,377,500 lekë tërhiqet nga zj. Frida Selfo dhe 65,377,500 lekë tërhiqet nga z. Ardit Selfo do të paraqiten në tabelën nr.1



- Vendimi i datës 26/04/2021, i ortakëve të shoqërisë, për zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me 50 % të kuotave, i formuar nga 100,000 leke kontribut në të holla në momentin e themelimit të shoqërisë dhe zmadhuar nga fitimet e rezervat të cilat do të tërhiqen si dividend në momentin e zvogëlimit, është marrë pasi Shoqëria ka burime aktive dhe mundësi për mbulimin e këtij pakësimi në formen e aktiveve financiare dhe në të holla.
- Në aneksin bashkëlidhur me raportin, pasqyrohen të gjitha veprimet fillestare të formimit të kapitalit dhe shtesat e kapitalit ndër vite deri në realizimin e shumës 261,510,000 lekë.
- Rregjistrimet në kontabilitet, të vendimit të ortakëve për zvogëlimin e kapitalit do të jenë.

Tabela nr.1

Veprimet për pakësimin e kapitalit themeltar

Nr	Nr llogarisë	Llogaritë	Debitohen (pakësohen)	Kreditothen (Shtohen)
1	101	Kapitali themeltar	130,755,000	
2	456	Ortakë për dividend Frida Selfo		65,352,500
3	456	Ortakë për dividend Ardit Selfo		65,352,500
4	456	Ortakë për kontribute në të holla Frida Selfo		25,000
5	456	Ortakë për kontribute në të holla Ardit Selfo		25,000
		SHUMA	130,755,000	130,755,000

Tabela nr.2

VEPRIMET NË KONTABILITET PËR DETYRIMET E PAGESËS TË DIVIDENTIT

NR	NR LLOGARISE	LLOGARITË	DEBITOHEN (PAKËSOHEN)	KREDITOHEN (SHTOHEN)
1	456	Ortakë për dividend znj, Frida Selfo	9,802,875	
2	449	Tatim për dividend të tërhequr znj, Frida Selfo		9,802,875
3	456	Ortakë për dividend z, Ardit Selfo	9,802,875	
4	449	Tatim për dividend të tërhequr z, Ardit Selfo		9,802,875
		SHUMA	19,605,750	19,605,750

Tabela nr.3

VEPRIMET MBAS PAKËSIMIT TË KAPITALIT TË NËNSHKRUAR DATË 31.12.2020

NR.R	Nr. llog	Llogaritë	Ishte	Pakësuar	Bëhet
1	101	Kapitali i Nenshkruar	261,510,000	130,755,000	130,755,000
		SHUMA	261,510,000	130,755,000	130,755,000

KONKLUZIONE

1. Data e Themelimit të shoqërisë 21/05/2010.
2. Administrator i shoqërisë Z. Behar Berdica.
3. Ortakë para zvogëlimit të kapitalit:
 - i. Behar Berdica me 50 % të kapitalit prej 261,510,000 lekë e barasvlefshme me 130,755,000 lekë
 - ii. Ardit Selfo me 25 % të kapitalit prej 261,510,000 lekë e barasvlefshme me 65,377,500 lekë.
 - iii. Frida Selfo me 25 % te kapitalit prej 261,510,000 lekë e barasvlefshme me 65,377,500 leke.
4. Ortakë mbas zvogëlimit të kapitalit:
Behar Berdica me 100 % të kapitalit prej **130,755,000** lekë e barasvlefshme me **130,755,000** lekë.
5. Kapitali i themelimit të shoqërisë, i regjistruar para zvogëlimit, është **261,510,000** lekë.
6. Pakësim kapitali me vendim ortakësh të datës 26/04/2021 me vlerë **130,755,000** lekë, ardhur nga kontributet në të holla në themelim në vlerën 100,000 leke dhe fitimet ndër vite.
7. Kapitali i shoqërisë mbas zvogëlimit **130,755,000** leke nga **261,510,000** lekë, bëhet **130,755,000** lekë.
8. Kapitali themeltar pakësohet me **130,755,000** lekë dhe mbas pakësimit **nga 261,510,000** lekë, **merr** vlerën **130,755,000** leke , i ndarë në 100 pjesë me vlerë **1.307,550** lekë çdo pjesë.
9. Kapitali mbas pakësimit pra i mbetur **130,755,000** zoterohet 100 % nga z.Behar Bërdica.
10. Kapitali i tërhequr në formë dividenti nga ortakët znj. Frida Selfo ne vleren 65,352,500 dhe z.Ardit Selfo në vlerën 65,352,500 , shtuar me parë ndër vite nga fitimet brenda shoqërisë.
11. Kapitali i zvogeluar nga kontributi fillestar ne të holla 50 % e 100 mijë lekë në vlerën 50,000 lekë, përkatësisht nga 25,000 lekë znj. Frida Selfo dhe Ardit Selfo.

Drejtimi i shoqërisë të deklaroj vendimin në Qëndrën Kombëtare të Biznesit dhe Institucionet Tatimore brenda afateve ligjore.

Shkodër më 27/04/2021

Auditues Ligjore

Eftali Qirjaqi

